EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 7082
E premte, 29 dhjetor 2023
Çmimi 0. 50 €

Vdiq ish-senatori zviceran Dick Marty

FAQE 2

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KDI-ja PËR PUNËN E KUVENDIT GJATË 2023-s: GATI ÇDO SEANCË ËSHTË DASHUR TË NDËRPRITET PËR MUNGESË KUORUMI

FAQE 4-5

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka shpalosur raportin analitik mbi punën e Kuvendit të Kosovës gjatë vitit 2023. Sipas KDI-së, puna e Kuvendit të Kosovës këtë vit është karakterizuar me mangësi të shumta duke çuar në performancë të dobët në krahasim me vitin paraprak. Gjatë vitit janë mbajtur gjithsej 78 seanca të cilat për shkak të planifikimit të dobët dhe mungesës së deputetëve prodhuan 27 vazhdime. Përveç këtyre, u mbajtën edhe 13 seanca të jashtëzakonshme dhe 2 seanca solemne

ÇITAKU: KY VIT, MË I DËSHTUARI PËR KOSOVËN NË POLITIKËN E JASHTME

F. 7

HAPEN KORRIDORET AJRORE KOSOVË - SHQIPËRI

F. 5

AKTUALE

LIGJI PËR PAGA: KË E PREK VENDIMI I KUSHTETUESES? F. 6

NAGAVCI: VITIN E ARDHSHËM MËSIMDHËNËSIT TESTOHEN PËR LICENCË TË AVANCUAR F. 3

FRYRJA E FATURAVE TË RRYMËS, KMDLNJ: PROKURORIA E SHTETIT DUHET T'I FILLOJË HETIMET F. 7

EKONOMI

AS NJË E PESTA E PRONAVE NË KOSOVË NUK ZOTËROHET NGA GRATË F. 8

ATK-ja PARAQET ARRITJET E VITIT 2023 F. 8

SPORT

BORDI I FBK-SË UA NDALON GJYQTARËVE NGA KOSOVA TË NDAJNË DREJTËSINË NË LIGËN BALLKANIKE F. 10

RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht -Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

Vdiq ish-senatori zviceran Dick Marty

PRISHTINË, 28 DHJETOR - Ka vdekur në moshën 78-vjeçare ish-senatori zviceran Dick Marty, ka bërë me dije partia e tij, Partia Demokracia e Lirë (FDP).

Marty ishte anëtar i Këshillit të Evropës dhe Komisionit të OSBE-së për të Drejtat e Njeriut.

Në Kosovë Marty u bë i njohur pasi hartoi raportin për këtë vend në vitin 2010 i cili pastaj u miratua nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës.

Raporti pretendoi se në trafikim të organeve kanë qenë të përfshirë udhëheqës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës gjatë luftës së viteve 1998-99. Këto pretendime janë hetuar nga prokurori amerikan Clint Williamson, i cili në korrik të vitit 2014 ka bërë me dije se gjetjet e ekipit të tij nuk përfshijnë dëshmi të bazuara për trafikim organesh, por për krime të tjera lufte.

Kjo, në vitin 2015, ka çuar në formimin e Dhomave të Specializuara të Kosovës, për t'i hetuar krimet e pretenduara të pjesëtarëve të UÇK-së kundër pakicave etnike dhe rivalëve politikë, që dyshohet se janë kryer nga janari i vitit 1998 deri në dhjetor të vitit 2000.

Izraeli vazhdon ta bombardojë Gazën prej tri fronteve

GAZA, 28 DHJETOR - Ushtria e Izraelit e ka sulmuar qendrën e Gazës prej tokës, detit dhe ajrit, teksa autoritetet palestineze kanë raportuar për dhjetëra vdekje të tjera.

Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) ka thënë se mijëra njerëz janë duke tentuar t'u ikin luftimeve.

Izraeli vazhdon të jetë i vendosur për ta shkatërruar Hamasin pas sulmeve të grupit, më 7 tetor, në jug të Izraelit, pavarësisht prej thirrjeve për armëpushim ndërkombëtar dhe mospërkeqësim edhe të madh të krizës humanitare në Rripin e Gazës.

Hamasi, grup palestinez që udhëheq Rripin e Gazës, është shpallur organizatë terroriste prej Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian.

Aeroplanët izraelitë kanë kryer tri sulme në qendër të Gazës, duke vrarë shtatë njerëz dhe duke plagosur dhjetëra të tjerë, kanë

thënë mjekët në orët e vona të së mërkurës.

Organizata Botërore e Shëndetësisë ka thënë se stafi i saj ka parë dhjetëra mijëra njerëz duke iu ikur sulmeve në Han Junis në këmbë, me gomarë, apo me makina.

Tendat e improvizuara janë duke u ndërtuar nëpër qoshe të rrugëve.

Në frontin diplomatik, ku po rritet presioni ndaj Izraelit, presidenti francez Emmanuel Macron i ka thënë kryeministrit izraelit Benjamin Netanyahu, që duhet të punohet drejt një armëpushimi afatgjatë, me ndihmën e partnerëve rajonalë dhe atyre ndërkombëtarë, ka thënë Presidenca franceze.

Lufta në Gazë ka shpërthyer pasi Hamasi ka vrarë 1 200 njerëz dhe i ka marrë 240 pengje në sulmet në jug të Izraelit, më 7 tetor - njëherësh sulmi më i rëndë në historinë e shtetit.

Ministria e Shëndetësisë në Gazë ka thënë se mbi 21 000 njerëz janë vrarë dhe mbi 55 000 janë plagosur si pasojë e ofensivës izraelite.

Deri më tani besohet se të gjithë 2.3 milionë banorët e Gazës janë detyruar të largohen prej shtëpive të tyre.

ShBA-ja miraton ndihmën e fundit ushtarake për Ukrainën për këtë vit

UASHINGTON, 28 DHJETOR - Shtëpia e Bardhë e ka miratuar një tjetër ndihmë ushtarake për Ukrainën në vlerë të 250 milionë dollarëve.

Në paketën e fundit përfshihen armë për mbrojtje ajrore, artileri, municion i vogël dhe armë anti-tank, kanë thënë zyrtarët amerikanë.

Mirëpo kjo është ndihma e fundit që mund të niset prej ShBA-së në Ukrainë, nëse Kongresi amerikan nuk miraton ndihmë shtesë.

Ukraina ka paralajmëruar që lufta dhe financat e saj publike do të jenë në rrezik të madh nëse do të ndalen ndihmat prej Perëndimit.

Ukraina ka regjistruar ndryshim të vogël të linjës së kontrollit pas nisjes së kundërofensivës pranverore dhe tani po përballet me një rënie graduale të ndihmave prej aleatëve në Uashington dhe Evropë.

Ndonëse mbështetja për Ukrainën është e madhe në Kongresin amerikan, një marrëveshje për dërgim të mëtutjeshëm të armëve është bllokuar prej republikanëve, të cilët insistojnë që duhet ndarë më shumë buxhet për ta forcuar kontrollin e kufijve të ShBA-së me Meksikën.

Një paketë emergjente për shpenzime, që përfshin ndarjen e 50 miliardë dollarëve për Ukrainën dhe 14 miliardë dollarëve për Izraelin, nuk është miratuar në Senatin amerikan muajin e kaluar, pasi çdo republikan ka votuar kundër.

Edhe një vizitë e realizuar së fundi në ShBA nga presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky nuk ka rezultuar me sukses në këtë drejtim.

Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, ka thënë se është e rëndësishme që Kongresi të veprojë sa më shpejt, "për t'i avancuar interesat tona kombëtare, duke i ndihmuar Ukrainës që ta mbrojë veten dhe të ardhmen e saj".

Më herët gjatë këtij muaji, një paketë ndihme për Ukrainën e Bashkimit Evropian, është bllokuar nga Hungaria.

Ukraina po përballet me deficit në vlerë 43 miliardë dollarëve dhe zyrtarët ukrainas frikësohen se mund t'i vonojnë pagat dhe pensionet për punëtorët qeveritarë, nëse nuk pranohet ndihmë shtesë prej Perëndimit.

Presidenti rus Vladimir Putin e quan luftën "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar Ukrainën.

Perëndimi është përgjigjur ndaj Rusisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të

ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

EPOKA E RE

Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Çitaku: Ky vit, më i dështuari për Kosovën në politikën e jashtme

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 28 DHJETOR - Nënkryetarja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Vlora Çitaku, ka vlerësuar se Kosova po përmbyll vitin më të rëndë dhe më të dështuar në politikën e jashtme që nga shpallja e pavarësisë, pa njohje, pa anëtarësime në organizata ndërkombëtare dhe pa avancim të agjendës eurointegruese dhe nën sanksione nga ana e Bashkimit Evropian.

Çitaku, në një konferencë për medie, ka thënë se politika e jashtme e Kosovës është karakterizuar nga kakofonia, mungesa e vizionit dhe shumësia e skandaleve. "Suksesi i vetëm i kësaj qeverie është angazhimi i këshilltarëve me paga mijëra euro në muaj, pa asnjë rezultat për Kosovën. Qasja e papërgjegjshme e Qeverisë së Kosovës, kacafytja e hapur dhe publike me aleatët tanë kryesorë, solli reduktimin e ambicieve për Kosovën nga ndërmjetësit e dialogut. Dhe, si rrjedhojë, përfunduam me një marrëveshje e cila nuk është as gjithëpërfshirëse, as finale, as me njohje reciproke në qendër. Përfunduam me një draft-statut të pranuar nga kryeministri Kurti, i cili në esencë është një Kushtetutë për serbët e Kosovës dhe krijon një sistem paralel brenda Republikës sonë", ka theksuar ajo.

Ajo ka thënë se nuk ka njeri me mendje të shëndoshë i cili do ta donte këtë lloj pasqyre negative në politikën e jashtme. "Në një vit kur u konkretizua procesi i anëtarësimit në Bashkimin Evropian, qoftë me miratimin e statusit kandidat, qoftë me hapjen e negociatave për Bosnjë-Hercegovinën, Ukrainën, Gjeorgjinë, Moldavinë, aplikacioni i Kosovës mbeti i patrajtuar dhe Kosova vazhdon të mos ketë qasje në qindra miliona euro të fondeve zhvillimore të

dedikuara për Ballkanin Perëndimor", ka shtuar Çitaku.

Çitaku rikujtoi se PDK-ja ka ofruar mbështetje në fuqizimin ndërkombëtar të Kosovës, ku kryetari Memli Krasniqi dhe zyrtarët e tjerë të partisë, në takimet dhe vizitat e shumta jashtë vendit, kanë insistuar që qytetarët e Kosovës të mos e bartin koston e sjelljes së papërgjegjshme dhe aventuriere të qeveritarëve. "Do të doja që në këtë konferencë të flisnim për tema të tjera, sepse sukseseve të Kosovës në politikën e jashtme duhet t'iu gëzohemi të gjithë. Fatkeqësisht, me gjithë përpjekjet për të gjetur qoftë edhe një sukses të Kosovës në politikën e jashtme, ishte e pamundur. Realisht, politika e jashtme e Republikës sonë këtë vit ishte inekzistente. Në vitin tjetër, me mbajtjen e zgjedhjeve të reja, kjo mendësi rrënuese dhe përçarëse e kësaj qeverie do të marrë fund", ka theksuar Çitaku.

Nagavci: Vitin e ardhshëm mësimdhënësit testohen për licencë të avancuar

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 28 DHJETOR - Ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Informacionit, Arbërie Nagavci, ka bërë me dije se nga qershori i vitit 2024 do të fillojë testimi i mësimdhënësve që duan licencë të avancuar.

Nagavci, në një konferencë për media të mbajtur më 28 dhjetor në Prishtinë, ka thënë se mësimdhënësit nuk janë kundër këtij testimi që do të mundësojë avancim në karrierë apo pagë më të lartë. "Tashmë kemi finalizuar infrastrukturën ligjore, udhëzimet administrative që e mundësojnë testimin e mësimdhënësve. Jemi në bashkëpunim me Këshillin Shtetëror për licencimin e mësimdhënësve dhe partnerët tanë, edhe në proces të krijimit të

udhëzuesit i cili do t'i bëjë të qarta të gjitha procedurat, kriteret dhe çdo gjë tjetër që është e nevojshme për realizimin me sukses të testit", ka thënë Nagavci.

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBAShK) e kundërshton idenë e testimit të mësimdhënësve si mënyrë për t'i rilicencuar ata.

Kryetari i kësaj sindikate, Rrahman Jasharaj, ka thënë më herët për Radion Evropa e Lirë se "një testim i tillë me shkrim" do të konsiderohej nënçmues dhe degradues nga mësimdhënësit, sepse ata i kanë përfunduar shkollimet përkatëse. Megjithatë, ai kishte theksuar se sindikalistët nuk janë kundër vlerësimit të performancës së mësimdhënësve si dhe gradimit të tyre.

Nagavci ka thënë se SBAShK-u nuk duhet ta kundërshtojë avancimin në karrierë për mësimdhënësit. "Besoj se mësimdhënësit nuk janë kundër... do të jenë të suksesshëm në këtë vlerësim që do të bëhet dhe do të arrijnë të avancohen në karrierë. Mund të ketë raste individuale, por nuk mendoj që është mirë për SBAShK-un të dalë në mbështetje të atyre të cilët mund të kenë probleme", ka thënë Nagavci.

Derisa ka folur për testimin për licencë të avancuar, Nagavci ka thënë se për këtë janë duke bashkëpunuar edhe me Shqipërinë dhe, sipas saj, më shumë rreth këtij testimi do të zbulojnë në tremujorin e vitit të ardhshëm. "Jemi në bashkëpunim me Republikën e Shqipërisë e cila e realizon një test të tillë për mësimdhënësit. Kolegët tanë kanë pasur disa takime tashmë dhe kemi punuar në këtë drejtim dhe këtë do ta bëjmë të ditur në tremujorin e parë të vitit të ardhshëm dhe synimi është që nga qershori të fillohet me test për licencën e avancuar", ka thënë Nagavci.

Cilësia e arsimit në sistemin parauniversitar të vendit është kritikuar shpesh nga institucionet ndërkombëtare. Në një raport që ka publikuar Banka Botërore në vitin 2020, është thënë se nxënësit në Kosovë "kanë ngecje të madhe në mësimnxënie".

Tahiri: 2023-a, vit i humbur për Kosovën!

PRISHTINË, 28 DHJETOR - Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, në konferencën e fundvitit, ka thënë se 2023-a ishte vit i humbur për Kosovën. Duke e rikapitulluar vitin 2023, ai ka theksuar rolin e AAK-së në këtë vit, njëkohësisht edhe dështimet të cilat ndodhën gjatë këtij viti. "Viti 2023 do të mbahet në mend si vit i cili e varfëroi secilin qytetar të Kosovës, pa dallim. Vit i cili e ngriti pasigurinë në vend, që nga aspekti social e deri tek ai i sigurisë. Ishte vit i eksperimentimit të shumicës së ministrave dhe dikastereve që udhëheqin, duke e kthyer Kosovën ndër vendet e para në listë për rezultatin më të dobët në PISA, në vendin me pagat më të ulëta në sektorin publik në rajon, në mosshpenzimin respektivisht investimin e jo më shumë se një miliard euro në projekte kapitale dhe me dështim të plotë në politikën e jashtme dhe subjektivitetin e Kosovës", ka thënë Tahiri.

Ai ka theksuar se viti 2023 do të mbahet mend si vit kur qeveria është munduar me të gjithë mekanizmat e saj t'i kapë institucionet e pavarura, në veçanti gjyqësorin. "Zhvillimi më i mirë dhe më i mrekullueshëm në 2024-n do të ishte largimi i kësaj qeverie dhe ndalja e dëmit që i bëhet Kosovës", ka thënë Tahiri.

KDI-ja për punën e Kuvendit gjatë 2023-s: Gati çdo seancë është dashur të ndërpritet për mungesë kuorumi

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka shpalosur raportin analitik mbi punën e Kuvendit të Kosovës gjatë vitit 2023. Sipas KDI-së, puna e Kuvendit të Kosovës këtë vit është karakterizuar me mangësi të shumta duke çuar në performancë të dobët në krahasim me vitin paraprak. Gjatë vitit janë mbajtur gjithsej 78 seanca të cilat për shkak të planifikimit të dobët dhe mungesës së deputetëve prodhuan 27 vazhdime. Përveç këtyre, u mbajtën edhe 13 seanca të jashtëzakonshme dhe 2 seanca solemne

EPOKA E RE Mal QORRAJ

PRISHTINË, 28 DHJETOR - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka mbajtur të enjten konferencë për medie gjatë së cilës ka shpalosur raportin analitik mbi punën e Kuvendit të Kosovës gjatë vitit 2023.

Arbër Thaçi, hulumtues në KDI, tha se puna e Kuvendit të Kosovës këtë vit është karakterizuar me mangësi të shumta duke çuar në performancë të dobët në krahasim me vitin paraprak.

Gjatë vitit janë mbajtur gjithsej 78 seanca të cilat për shkak të planifikimit të dobët dhe mungesës së deputetëve prodhuan 27 vazhdime. Përveç këtyre, u mbajtën edhe 13 seanca të jashtëzakonshme dhe 2 seanca solemne.

Sa i përket përmbushjes së agjendës legjislative të vitit 2023, Thaçi shtoi se përgjatë vitit të plotë të punës parlamentare, Kuvendi ka miratuar 71 projektligje, që prekin fushë të gjerë veprimi, ndërsa vetëm 29 nga këto projektligje janë pjesë e agjendës legjislative të vitit 2023.

Shprehur në përqindje, Kuvendi ka miratuar vetëm 25 % të agjendës legjislative të vitit 2023, ndërsa 42 projektligje të miratuara janë pjesë e agjendave të viteve 2022 dhe 2021.

Në mesin e dokumenteve të miratuara këtë vit janë edhe 16 marrëveshje ndërkombëtare. Miratimi i këtyre të fundit u zvarrit në Kuvend për muaj me radhë për shkak të mungesës së konsensusit mes pushtetit dhe opozitës.

Në anën tjetër, 45 projektligje kanë mbetur ende në procedura shqyrtuese brenda Kuvendit, të cilët janë pjesë e agjendës legjislative 2023 dhe agjendave të viteve të kaluara. Mes tyre, në pritje për miratim janë edhe 8 marrëveshje ndërkombëtare. Duhet të theksohet fakti se 55 projektligje apo 48 % e Programit Legjislativ të qeverisë të vitit 2023 nuk është dërguar fare në Kuvend.

Thaçi trajtoi edhe çështjen e mungesave të deputetëve, për të cilat tha se kanë shkaktuar mungesë të kuorumit dhe për pasojë kanë rezultuar me ndërprerje të pothuajse çdo seance në Kuvend.

Bojkotimi që deputetët nga radhët e Listës Serbe i kanë bërë punës parlamentare, e kanë rritur numrin e mungesave në përgjithësi, porse mungesa mbi një nivel të tolerueshëm gjenden edhe në grupet e tjera parlamentare.

Numerikisht, deputetët munguan 1 586 herë, apo shprehur në përqindje në secilën seancë të vitit 2023, munguan 23,5 % e deputetëve. Në një listim që përjashton deputetët që vijnë nga Lista Serbe, LDK-ja prin me 23,4 % të mungesave, duke u pasuar nga PDK-ja 18,9 %, Komunitetet 18,5 %, AAK-ja 16,2 %, LV-ja 12,4 %. Nga 5 deputetët me mungesat më të shumta, 4 vijnë nga partitë opozitare, konkretisht Lumir Abdixhiku me 44 mungesa, Behgjet Pacolli me 39, Memli Krasniqi me 35, Ardian Kastrati me 34 dhe Saranda Bojuevci me 24 mungesa. Dy deputetët e fundit kanë munguar për arsye shëndetësore.

Thaçi tutje theksoi se funksioni mbikëqyrës i Kuvendit është sfiduar seriozisht në disa raste si në atë kur kryeministri refuzoi t'u përgjigjet pyetjeve të deputetëve - duke i kushtëzuar ata me votimin e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe përmes bllokimit të formimit të komisionit hetimor për rezervat shtetërore - ku deputetët e pozitës munguan në mbledhje 8 herë radhazi.

Po ashtu, u theksua mungesa e llogaridhënies së ministrave të caktuar, si ai për Punë të Brendshme, Xhelal Sveçla, i cili për një vit nuk i është përgjigjur asnjë pyetjeje të deputetëve. Në formë të ngjashme edhe ministrat Hekuran Murati dhe Donika Gërvalla nuk ofruan asnjë përgjigje përgjatë sesionit vjeshtor. Në përgjithësi, gjatë këtij viti ekzekutiv iu është përgjigjur 117 pyetjeve parlamentare, nga 299 të tilla, apo shprehur në përqindje vetëm 39 % të tyre.

Në anën tjetër, Violeta Haxholli nga KDI-ja shtoi se megjithëse Kuvendi tanimë ka në fuqi një Rregullore të re të punës, zbatimi dhe interpretimi i papërshtatshëm i saj nga kryetari Glauk Konjufca ka qenë evident. Në disa raste ky i fundit nuk shqiptoi sanksionet që parasheh Rregullorja për deputetët që shkelën rregullat e sjelljes në Kuvend, siç janë përfshirja në dhunë fizike apo përdorimi i gjuhës joparlamentare.

Rregullorja u keqinterpretua edhe në raste të thirrje së seancave dhe administrimit të tyre.

Haxholli foli edhe mbi trajtimin që Kuvendi i ka bërë çështjes së Reformës në drejtësi, konkretisht projektligjeve që kanë ardhur nga qeveria lidhur me këtë fushë. Ajo theksoi se 24 % e të gjitha ligjeve të miratuara janë të lidhura me reformat në drejtësi, por si pasojë e mospajtimeve mes pushtetit dhe opozitës disa prej tyre përfunduan në Gjykatën Kushtetuese. I tillë ishte Ligji për Byronë Shtetërore për të cilin është në pritje opinioni nga Gjykata dhe ai për Këshillin Prokurorial i cili ishte shpallur i pavlefshëm.

Tutje, ajo theksoi konsensusin e arritur në parim mes pushtetit dhe opozitës lidhur me finalizimin e draft-amendamenteve kushtetuese për vetingun në drejtësi, përmes krijimit të komisionit të përbashkët ad-hoc. Por se ky konsensus duhet të vazhdojë tutje dhe të zgjerohet edhe te komunitetet joshumicë meqë për votimin e këtyre

SBAShK-u: Edhe këtë vit qeveria vazhdoi qasjen e gabuar ndaj sindikatave

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 28 DHJETOR - Këshilli Drejtues i SBAShK-ut ka mbajtur takimin përmbyllës duke analizuar aktivitetet e zhvilluara e duke bërë planifikime të veprimtarive sindikale për vitin 2024. Përfaqësuesit e të punësuarve që nga çerdhet e deri në universitete kanë vlerësuar se viti 2023 ishte me plot sfida, por edhe me arritje të shumta.

Kryetari i SBAShK-ut, Rrahman Jasharaj, duke paraqitur raportin e punës, ka deklaruar se, fatkeqësisht, edhe në vitin 2023 qeveria Kurti, edhe ministrja Nagavci, kanë vazhduar qasjen e gabuar ndaj sindikatave dhe i kanë ikur dialogut të mirëfilltë për çka përmes shkresave janë kritikuar edhe nga Unioni i Sindikatave të Arsimit të Evropës (ETUCE), që numëron 11 milionë anëtarë dhe Internacionales Botërore të Arsimit (EI), që numëron 32 milionë anëtarë.

Jasharaj ka kujtuar edhe tendencën e qeverisë për shuarjen e sindikatave përmes pengesave të regjistrimit në e-Kosova, por i ka shkuar huq, siç tha Jasharaj, sepse shumica e të punësuarve në arsim kaloi këto barriera duke dëshmuar se janë bashkë e në SBAShK. Ai pastaj i ka përgëzuar veprimtarët sindikalë dhe stafin qendror të cilët kanë arritur t'i realizojnë detyrat e planifikuara për vitin 2023.

Anëtarët e Këshillit Drejtues kanë bërë vlerësim të angazhimeve dhe aktiviteteve sindikale në komuna e në universitete duke përmendur trajnimet e organizuara me qindra punëtorë të arsimit, organizimin me sukses të aktiviteteve kushtuar ditës së madhe të mësuesit, rrjedhën e mbarë të pushimeve për qindra punëtorë arsimorë në bregdetin shqiptar dhe aktivitete të shumta me Qendrën Amerikane të Solidaritetit, duke veçuar punëtoritë sindikale në shtatë qendrat e Kosovës dhe tryezën përgatitore me pjesëmarrjen e të gjitha palëve që ndërlidhen me arsimin për ta mbajtur në shkurtin e vitit 2024 konferencën ndërkombëtare lidhur me ruajtjen dhe kujdesin për shëndetin mendor në shkolla.

Ata kanë theksuar se punëtorët e arsimit falë Kontratës Kolektive të Arsimit kanë realizuar përmes gjykatave benifite të shumta që u ka krijuar kjo Kontratë. Duke vlerësuar lart angazhimet e koordinatorit për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri, Këshilli Drejtues e shpalli atë sindikalist të vitit në SBAShK dhe i ka falënderuar ta gjithë sindikatat e Kosovës që në kuadër të BSPK-së e shpallën sindikalist të vitit në nivel vendi kryetarin e SBAShK-ut, Rrahman Jasharaj.

Hapen korridoret ajrore Kosovë - Shqipëri

PRISHTINË, 28 DHJETOR - Ministri i Infrastrukturës në Kosovë, Liburn Aliu, ka bërë me dije se Kosova i ka hapur korridoret ajrore me Shqipërinë. Në "Facebook", në orët e para të së enjtes, ai ka thënë se fluturimet drejt vendeve të Perëndimit do të shkurtohen për gati 15 minuta.

"Nga 1 janari, bashkatdhetarët, përveç që do të udhëtojnë pa viza, do të kursejnë edhe më shumë kohë", ka thënë Aliu. Ai i është referuar liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës që hyn në fuqi prej 1 janarit të vitit 2024.

Qytetarët e Kosovës kanë qenë të vetmit në Ballkanin Perëndimor që nuk kanë mundur të lëvizin pa viza në zonën për lëvizje të lirë, Shengen.

Albion Idrizi, magjistër i aviacionit, ka thënë muaj më parë për Radion Evropa e Lirë se pas hapjes së korridorit ajror të Kosovës me Shqipërinë, përveç shkurtimit të kohës së fluturimit, do të zvogëlohet edhe çmimi i biletave.

Aktualisht, sipas tij, çmimi mestar i një bilete njëdrejtimëshe nga Kosova për në të gjitha vendet e BE-së është 140 euro. Me shkurtimin e fluturimit, ky çmim mund të bjerë deri në 6 për qind, apo 8 euro, thotë Idrizi, ndërmarrës në fushën e udhëtimeve dhe turizmit në Kroaci dhe Kosovë.

Që nga paslufta, më 1999, fluturimet nga dhe në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës janë realizuar vetëm përmes korridorit ajror që e lidh Kosovën me Maqedoninë e Veriut.

Marrëveshja me Shqipërinë, për ta shfrytëzuar korridorin ajror të këtij vendi, është arritur në vitin 2020.

Kjo marrëveshje ka paraparë hapjen e dy pikave koordinuese ajrore, Kukad dhe Arbër. Sipas Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës (AAC), i cili menaxhon hapësirën e ulët ajrore të vendit, marrëveshja nuk është zbatuar për shkak të disa procedurave teknike që është dashur të miratohen nga Shqipëria dhe misioni i NATO-s në Kosovë, KFOR.

Ndryshe nga hapësira e ulët ajrore e Kosovës që menaxhohet nga AAC-ja, hapësira e lartë - ajo mbi 6 200 metra, e hapur për trafikun komercial nga viti 2014 - është nën kontrollin e Hungarisë, përkatësisht të HungaroControl-it, për shkak se Kosova nuk ka arritur ende kapacitete për ta menaxhuar hapësirën e lartë ajrore.

Në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, por edhe me ligjet e tanishme në Kosovë, komandanti i KFOR-it është përgjegjës për sigurinë e hapësirës ajrore të Kosovës që nga viti 1999. Për dhe nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari" udhëtojnë miliona persona brenda vitit.

Zvicra, Gjermania, Turqia, Austria dhe Mbretëria e Bashkuar kanë qenë, deri më tani, destinacionet më të shpeshta.

---

amendamenteve nevojiten 2/3 e votave të të gjithë deputetëve duke përfshirë edhe të komuniteteve.

Haxholli foli edhe rreth çështjes së transparencës së Kuvendit përgjatë vitit 2023, me theks të veçantë mungesën e pajisjeve elektronike në Kuvend të cilat pamundësuan votimin elektronik të deputeteve. Si rrjedhojë, për tri vjet me radhë qytetarët nuk dinë se si kanë votuar deputetët për ligjet e ndryshme. Po ashtu u kritikua edhe mungesa e publikimit të procesverbaleve dhe transkripteve nga ana e komisioneve, veçanërisht komisioneve ad-hoc dhe atyre hetimore, puna e të cilave mbetet plotësisht e panjohur për publikun.

Kuvendi, po ashtu, edhe këtë vit nuk lëvizi në drejtim të rregullimit të çështjes së lobimit, e cila do ta fuqizonte edhe më tepër transparencën dhe llogaridhënien në procesin ligjbërës.

Sa iu përket zhvillimeve në Komisionet Parlamentare u theksua se ato mbajtën gjithsej 358 mbledhje, numër në të cilin përfshihen edhe 17 dëgjime publike. Listës së komisioneve me aktivitet të lartë iu prinë Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere me 39 mbledhje dhe 2 dëgjime; Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti me 34 mbledhje dhe 5 dëgjime; Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale me 31 mbledhje dhe 4 dëgjime publike dhe Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit me 30 mbledhje.

Përgjatë sesionit komisionet kanë trajtuar mbi 70 projektligje, ndërsa në raportime kanë qenë 48 herë anëtarët e kabinetit qeveritar. Po ashtu, duhet të theksohet se një pjesë e aktivitetit të disa komisioneve konsistoi në vizita në terren dhe takime me zyrtarë institucionalë dhe përfaqësues ndërkombëtarë.

Sa i përket mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve, Haxholli theksoi se vetëm 5 ligje u mbikëqyrën në tërësi gjatë këtij viti nga komisionet parlamentare, një shifër që nuk është e mjaftueshme.

Ligji për Paga: Kë e prek vendimi i Kushtetueses?

PRISHTINË, 28 DHJETOR - Gjykata Kushtetuese e Kosovës shpalli të pavlefshme disa nene të Ligjit për Paga në sektorin publik, të miratuar në shkurt të këtij viti. Kjo Gjykatë veproi pas kërkesës së Avokatit të Popullit për kushtetutshmërinë e këtij ligji. Kushtetuesja vendosi se "paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41, për shtesat transitore, dhe paragrafi 2 i nenit 45 (shfuqizimi i Ligjit për presidentin e Republikës së Kosovës) të ligjit të kontestuar, shpallen të pavlefshëm me hyrjen në fuqi të aktgjykimit".

Çfarë nënkupton vendimi i Kushtetueses?

Ehat Miftaraj, drejtor i Institutit të Kosovës për Drejtësi, thotë se, sipas njoftimit të Gjykatës Kushtetuese, personave të cilëve iu zvogëlua paga me hyrjen në fuqi të Ligjit për Paga, do të vazhdojnë pafundësisht ta marrin pagën që e kanë pasur para hyrjes në fuqi të Ligjit për Paga, pasi Gjykata Kushtetuese ka anuluar paragrafin 2 të nenit 41 të Ligjit të Pagave. Ata do të vazhdojnë ta marrin shtesën transitore pafundësisht, deri kur rritja e koeficientit bën të arrihet apo tejkalohet vlera e pagës paraprake.

Si ka qenë deri më tani?

Shtesat transitore janë paguar që nga fillimi i zbatimit të këtij ligji në rast kur një zyrtar publik, para hyrjes në fuqi të këtij ligji, kishte pagë më të madhe se paga e re. Ai i punësuar ka përfituar pagën e re sipas dispozitave të ligjit të ri dhe shtesën transitore të barabartë me diferencën ndërmjet pagës aktuale dhe pagës së re bazë.

Gjatë vitit të parë shtesa transitore ishte paraparë të jetë 100 për qind, kurse gjatë vitit të dytë 50 për qind.

Miftaraj shtoi se shërbimi i jashtëm i Kosovës, që ka qenë i përjashtuar edhe nga shtesa transitore, do të trajtohet njëjtë sikurse para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Dispozita që i përjashton ata nga shtesa transitore anulohet. Ata nuk kompensohen retroaktivisht për dëmet që u janë shkaktuar nga hyrja në fuqi e Ligjit e deri më tani. Me ligj të ri, pagat, sikurse ato të ambasadorëve, janë zvogëluar.

Pagat janë zvogëluar edhe për presidentin e vendit për gjyqtarët e prokurorët.

Sipas Miftarajt, personat që janë punësuar pas hyrjes në fuqi të Ligjit do ta marrin pagën e njëjtë sikurse kolegët e tyre dhe ata nuk do të kompensohen retroaktivisht për dëmet që u janë shkaktuar nga hyrja në fuqi e Ligjit e deri më tani. "Dispozita që e ul shpërblimin për përvojën e punës nga 0.5 % në 0.25 % për 15 vjetët e parë, është në kundërshtim me Kushtetutën. Kjo dispozitë nuk anulohet, porse Kuvendi obligohet që brenda 6 muajve ta adresojë këtë çështje. Ndërsa efekti i aktgjykimit për këtë pjesë shtrihet nga data e publikimit të aktgjykimit", thotë Miftaraj.

Ai shton se Gjykata Kushtetuese "e ruajti pavarësinë funksionale të sistemit të drejtësisë në atë mënyrë që anuloi dispozitat që i obligonin institucionet e sistemit të drejtësisë të kërkonin miratim nga Ministria e Punëve të Brendshme me rastin e krijimit të funksioneve apo pozitave të reja".

Neni 41: Shtesa transitore

1. Nëse një zyrtar/e publik/e apo funksionar/e publik/e, para hyrjes në fuqi të këtij ligji përfitonte pagë që është më e madhe se paga e plotë e parashikuar me këtë ligj, ajo/ai do të përfitojë pagën e re sipas dispozitave të këtij ligji dhe shtesën transitore të barabartë me diferencën ndërmjet pagës aktuale dhe pagës së re bazë.

2. Të punësuarat/it, zyrtarja/i publik/e apo funksionarja/i publik/e, në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, do të përfitojë pagën e re në: 2.1. 100 % të shtesës transitore të posaçme, sipas paragrafit 1, gjatë vitit të parë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji; 2.2. 50 % të shtesës transitore të posaçme, sipas paragrafit 1, gjatë vitit të dytë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. 3. Përjashtimisht nga paragrafi 1. dhe 2. i këtij neni, anëtaret/ët e shërbimit të jashtëm nuk gëzojnë të drejtën e shtesës transitore. 4. Çdo person që punësohet pas miratimit të këtij ligji përfiton pagën sipas këtij ligji dhe nuk gëzon të drejtën e shtesës transitore.

Çfarë u anashkalua?

Megjithatë, Miftaraj thotë se disa nga çështjet që u anashkaluan nga Gjykata është ajo e shtesave pa orar të paracaktuar për zyrtarët, të cilët nuk e kanë të njohur saktë orarin e tyre të punës. "Sipas Ligjit të Pagave, kjo shtesë nuk i jepet secilit zyrtar publik që punon në këto rrethana, por vetëm zyrtarëve politikë të kabineteve që punojnë në këto rrethana. Kjo çështje nuk trajtohet fare në njoftim, pra as nuk konfirmohet as nuk anulohet. Ka pak gjasë që aktgjykimi të përmbajë dispozita të cilat e mbulojnë këtë çështje", sqaron Miftaraj.

Ai thotë se nuk adresohet në mënyrë adekuate çështja e retroaktivitetit në raport me personat e punësuar në shërbimin e jashtëm pas hyrjes në fuqi të ligjit. "Kjo pasi dëmtimi pasuror që u është krijuar atyre, për shkak të shkeljes së Kushtetutës të konstatuar nga Gjykata, nuk do të kompensohet retroaktivisht, por efekti i aktgjykimit për këtë pjesë shtrihet nga momenti i publikimit të aktgjykimit".

Miftaraj thotë se për shkak të zbatimit të shtesës transitore, deri më tani askush nuk është dëmtuar nga Ligji për Paga: "Në këtë situatë mënyra e veprimit tutje në raport me ekzekutimin e pagave është e thjeshtë: Pagat duhet të vazhdojnë të ekzekutohen sikurse deri më tani, porse pagesa e shtesës transitore duhet të vazhdojë pafundësisht të paguhet deri në nivelin e pagës më të lartë që ka ekzistuar para hyrjes në fuqi të Ligjit të Pagave. Pra, në vitin e dytë, tashmë kjo shtesë nuk duhet të reduktohet". "Nga data e publikimit të aktgjykimit pagat e shërbimit të jashtëm duhet të jenë ato që kanë qenë para hyrjes në fuqi të Ligjit, në rastet kur paga në atë kohë ka qenë më e lartë, apo të vazhdojë të paguhet sipas Ligjit të Pagave, nëse ka raste kur pjesëtarët e shërbimit të jashtëm nuk janë ndikuar negativisht nga hyrja në fuqi e Ligjit për Paga".

Çfarë pritet tash?

Sipas Miftarajt, brenda gjashtë muajve Kuvendi duhet t'i miratojë ndryshimet që kanë të bëjnë me përvojën e punës. Sa iu përket shtesave, institucionet e pavarura, sipas nenit 2.3 të Ligjit për Paga, nuk kufizohen nga tavanet buxhetore të vendosura në Ligjin për Paga. Me rastin e krijimit të funksioneve apo pozitave të reja, institucionet e pavarura nuk duhet të kërkojnë miratim nga MPB-ja.

Fryrja e faturave të rrymës, KMDLNj: Prokuroria e Shtetit duhet t'i fillojë hetimet

PRISHTINË, 28 DHJETOR - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka theksuar se fryrja e faturave të energjisë elektrike edhe këtë fundvit është kryelajmi i fundvitit. "Edhe më kryelajm se vet ndarja e dhuratave nga kryeministri i Kosovës. Për fatin e keq të qytetarëve të Kosovës, të cilët që nga paslufta janë diskriminuar nga të gjitha qeveritë, e po vazhdon edhe më tutje, sikur nuk po mjafton kjo ata po vazhdojnë edhe të plaçkiten përmes fryrjes së faturave në kohë festash, në kohën e një ekonomie gati të rrënuar dhe në prag të liberalizimit të vizave", është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

ZRrE-ja ka deklaruar se nuk ka pranuar numër të lartë të ankesave, kurse po të hysh në rrjete sociale dhe në portale, dëshmohet totalisht e kundërta.

KMDLNj mendon se qytetarët e Kosovës e kanë humbur (nëse ndonjëherë e kanë pasur) besimin në ZRrE që mund të mbajë anën e drejtë të qytetarëve të Kosovës. "Deri më tani, për vite me radhë qytetarët shqiptarë të cilët janë detyruar që të paguajnë në kohë gjithë faturën e energjisë elektrike, përfshirë këtu edhe plaçkitjet që u janë bërë, e që për këtë ka dhe në vendim të Gjykatës Kushtetuese, se janë vjedhur qytetarët përmes fryrjes së faturave, ZRrE si autoritet rregullativ asnjëherë nuk ka treguar vullnet që të jetësojë me korrektësi detyrat e saj që e obligon edhe ligji. Jo që ende nuk kanë gjetur mënyrën e duhur t'ua kthej mjetet qytetarëve për plaçkitjet e mëparshme por po vazhdon të njëjtën rrugë", thuhet në këtë reagim të KMDLNj-së.

Sipas KMDLNj-së, Prokuroria e Shtetit do të duhej që, sipas detyrës zyrtare, t'i fillojë hetimet sa iu përket ankesave të qytetarëve për fryrje të faturave të energjisë

elektrike dhe t'o marrë për bazë edhe ankesat e shprehura edhe në rrjetet sociale. "KMDLNj u bënë thirrje të gjithë qytetarëve që të ngrenë zërin për shkeljen e të drejtave të tyre duke shfrytëzuar të gjitha mjetet demokratike. KMDLNj gjithashtu u kërkon që në mënyrë individuale të gjithë qytetarët të bëjnë padi kundrejt KEDS, KESCO dhe ZRrE për shkelje të të drejtave të tyre për fryrje të faturave të energjisë elektrike, për moszbatim të vendimit të Gjykatës Kushtetuese për kthim të mjeteve të plaçkitura dhe në të njëjtën kohë të paguajnë vetëm faturat e muajit të kaluar derisa të zbardhet e vërteta për fryrjet e këtij muaji. KMDLNj i rekomandon qytetarët e Kosovës që faturat t'i paguajnë vetëm në shumën e muajit paraprak. KMDLNj kërkon nga deputetët e Kuvendit të Kosovës që të thërrasin një seancë të jashtëzakonshme dhe të këmbëngulin për hetime për këto fatura të jashtëzakonshme. KMDLNj kërkon dorëheqje të bordit të ZRrE dhe hetime për drejtuesin e Bordit. KMDLNj thërret qytetarët e Kosovës që të organizohen dhe të protestojnë pa ndërprerë para zyrave të ZRrE, Kuvendit të Kosovës dhe KEDS-it", është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

KOMF-i, letër kryeministrit: Shërbimet sociale rrezikojnë të mbyllen në janar

PRISHTINË, 28 DHJETOR - Koalicioni i Organizatave për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë - KOMF, i cili përfaqëson 35 organizata joqeveritare, ka adresuar sot një letër të hapur te kryeministri Albin Kurti, ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati dhe ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, duke kërkuar ndërmarrjen e masave të menjëhershme për parandalimin e mbylljes së shërbimeve sociale për fëmijët e cenueshëm.

Konkretisht, KOMF ka kërkuar sigurim të financimit për ofrimin e shërbimeve sociale, të cilat janë jetike për fëmijët e cenueshëm, shërbime të cilat si pasojë e mosmbështetjes financiare nga qeveria rrezikojnë të mbyllen nga 1 janar 2024. "Shërbimet rezidenciale dhe shërbimet ditore për fëmijët pa përkujdesje prindërore, fëmijët viktima të abuzimit dhe keqtrajtimit, fëmijët viktima të dhunës në familje dhe viktimat e trafikimit (niveli i ulët dhe i mesëm i rrezikut), fëmijët me

aftësi të kufizuara etj., financohen pjesërisht nga Ministria Drejtësisë përmes thirrjeve publike çdo vit. Nga viti 2016 ka zbrazëtira kohore mes thirrjeve/kontratave për mbështetje të këtyre shërbimeve duke lënë pa përkrahje financiare këto shërbime çdo fillim vit. Institucionet jopublike të licencuara për ofrimin e shërbimeve sociale janë mbështetur financiarisht nga Ministria e Drejtësisë për ofrimin e shërbimeve. Mbështetja financiare nga Ministria e Drejtësisë ka qenë për periudhën prill 2023 - janar 2024 dhe, si rrjedhojë, shërbimet posedojnë financimin vetëm deri në janar 2024. Në mungesë të fondeve për mbështetje të mëtutjeshme shërbimet rrezikojnë të mbyllen", është thënë në këtë letër.

Më tutje, theksohet se ndërprerja e ofrimit të këtyre shërbimeve, qoftë edhe përkohësisht, do të lërë pa strehë fëmijët viktima të akomoduar aktualisht në strehimore dhe, po ashtu, do ta mbyllë derën për rastet e reja që mund të jenë në nevojë për shërbime rezidenciale, duke shkelur kështu të drejtën themelore të fëmijëve për mbrojtje.

KOMF ka bërë me dije se me situatë të njëjtë do të përballen edhe ofruesit e shërbimeve që ofrojnë shërbime në baza ditore për fëmijët e cenueshëm përmes qendrave ditore. "Në mungesë të shërbimeve sociale, fëmijët e cenueshëm, e sidomos fëmijët më aftësi të kufizuara do të mbesin të mbyllur në shtëpi dhe do të pësojnë regres në zhvillimin e tyre fizik, psikologjik dhe emocional. Kjo situatë, do të rëndojë edhe gjendjen ekonomike dhe emocionale të familjeve të fëmijëve të cenueshëm, të cilët do të detyrohen që të marrin shërbime me pagesë, në bazë të mundësive të tyre financiare. Krahas mbylljes së shërbimeve, do të pasojë edhe mbyllja e qendrave të specializuara për shërbime ditore, të cilat janë të pajisura me mjete pune, infrastrukturë, staf profesional dhe të licencuar. Po ashtu, ky vakum kohor, rrezikon humbjen e stafit profesional në të cilin është investuar ndër vite", thuhet në këtë letër.

KOMF-i përmes letrës ka kërkuar: Ndërmarrjen e masave të menjëhershme për parandalimin e mbylljes së shërbimeve sociale dhe ndarjen e një fondi emergjent për periudhën kohore janar - prill 2024, deri në hapjen e shpalljes së rregullt nga Ministria e Drejtësisë (fondi emergjent është praktikë që është ndjekur vitin e kaluar).

Kryhet me sukses intervenim i rrallë te një pesëvjeçar që ishte diagnostikuar me veshkë jofunksionale

PRISHTINË, 28 DHJETOR - Për herë të parë është realizuar me sukses Nefrektomia laparoskopike - "Laparoscopic Nephrectomy Ribbon Technique" në Klinikën e Kirurgjisë së Fëmijëve nga ekipi i kirurgëve pediatrikë në bashkëpunim me anesteziologët e Klinikës së Anesteziologjisë.

Intervenimi është realizuar te një fëmijë i moshës pesëvjeçare me inicialet A. S., i diagnostikuar me veshkë jofunksionale si pasojë e hidronefrozës së gradës së katërt.

Javë më parë, gjithashtu, është realizuar për të tretën herë një tjetër rast sfidues "Laparascopic assisted pull through" te një fëmijë i moshës njëvjeçare me sëmundjen e Hirschsprung-ut (megakoloni kongjenital).

Raste të tilla sfiduese të cilat kryhen në qendra të specializuara dhe me përvojë janë realizuar me sukses të plotë edhe në Klinikën e Kirurgjisë së Fëmijëve në QKUK, ku për mbi 4 vjet janë realizuar intervenime laparaskopike te fëmijët me patologji të ndryshme si: testisi intraabdominal, varikocela e testisit, divertikuli i Meckeli-it, tumoret e vezoreve, ciste e veshkës, apendektomia laparoskopike, kolecistektomia laparoskopike dhe Cista e Ekinokokut të Mëlçisë.

Me avancimin e mëtutjeshëm të "Kirurgjisë Minimale Invazive" do të mund të trajtohen shumica e patologjive me intervenime laparaskopike në Klinikën e Kirurgjisë së Fëmijëve në ShSKUK.

As një e pesta e pronave në Kosovë nuk zotërohet nga gratë

Prishtinë, 28 dhjetor - Edhe pse Kushtetuta e Kosovës ua garanton të drejtën për pronë të gjithëve, janë më pak se 20 për qind e pronave të paluajtshme që janë të regjistruara në emër të grave.

Shukrija me vite kishte kërkuar nga bashkëshorti i saj që shtëpinë e ndërtuar bashkërisht në Prishtinë ta regjistronin në emër të të dyve por, kot. "Sipas tij, ka mjaftuar të jetë në emrin e tij. Nuk e di nëse ka pasur presion nga familjarët apo zakonet", thotë pensionistja 68-vjeçare, dikur punonjëse në sektorin publik.

Duke folur për "Radion Evropa e Lirë", ajo tregon se ka mbetur e ve nga viti 2003. Atëkohë thotë se i është dashur të largohet edhe nga shtëpia e saj për shkak të presionit të familjarëve të bashkëshortit. Sipas saj, ata pretendonin se shtëpia u takonte atyre, meqë çifti nuk kishte fëmijë.

Pas disa vjetësh Shukrija nisi procedurat gjyqësore për rikthimin e së drejtës mbi pasurinë e saj, por ato vijojnë ende dhe Shukrija vazhdon të banojë në një shtëpi të të afërmve.

Në Kosovë, sipas të dhënave të Agjencisë Kadastrale të siguruara nga Radio Evropa e Lirë, janë 608 317 prona të regjistruara - prej tyre 476 394 ose 78.31 për qind në emër të burrave dhe 119 728 ose 19.68 për qind në emër të grave.

Në këto statistika, megjithatë, nuk saktësohet se sa gra janë pronare të vetme dhe sa në bashkëpronësi.

Ky hendek në shifra ekziston pavarësisht prej ligjeve dhe udhëzimeve që përcaktojnë se të gjithë qytetarët e Kosovës mund të kenë prona në emrin e tyre dhe se asnjëri nuk mund të privohet nga kjo e drejtë. Për më tepër, në Ligjin për Familje thuhet se "prona e fituar me punë gjatë martesës është e përbashkët".

Ndikimi i normave shoqërore

Nga sektori civil thonë se përqindja e pronave në emër të grave është tejet e ulët, marrë parasysh edhe faktin se më shumë se gjysma e popullsisë 1.7-milionëshe të Kosovës i takon gjinisë femërore, sipas Agjencisë së Statistikave.

Edona Selimi, nga Nisma për Drejtësi dhe Barazi, INJECT, thotë se tradita patriarkale në vend i favorizon djemtë në trashëgimin e pronave, ndërsa vajzat dhe gratë i bën të cenueshme ndaj formave të ndryshme të diskriminimit, përfshirë edhe dhunën në baza gjinore. Sipas saj, pronat do t'u ofronin grave siguri fizike dhe ekonomike.

Në organizatën e saj, INJECT, gratë viktima të dhunës në familje marrin këshilla juridike falas. "Një numër i madh i grave që përjetojnë dhunë në familje [nga bashkëshorti], hezitojnë t'i fillojnë procedurat e shkurorëzimit, pasi që nuk kanë mbështetje financiare, nuk kanë prona në emër të tyre e as trashëgimi në familjet e tyre… Janë të papuna dhe nuk kanë ku të shkojnë. Në këto raste shumica detyrohen të kthehen te kryesi i dhunës", thotë Selimi për Radion Evropa e Lirë.

Kosova e ka Ligjin për Trashëgiminë i cili qartazi përcakton se ndarja e pasurisë bëhet në mënyrë të barabartë, pa përjashtuar anëtarët në baza gjinore. Megjithatë, ky ligj përfshin edhe heqjen dorë në mënyrë vullnetare nga trashëgimia.

Sipas vlerësimeve të organizatave të ndryshme në Kosovë, vetëm rreth 4 për qind e grave janë trashëguese të pronave familjare, ndërsa sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës shkalla e punësimit të grave është nën 20 për qind dhe ato paguhen më pak sesa burrat.

REL-i ka raportuar edhe më herët se si gratë viktima të dhunës në Kosovë, në mungesë të pavarësisë ekonomike, detyrohen të durojnë dhunë, të zhvendosen në strehimore, apo të ikin përkohësisht dhe të kthehen prapë te dhunuesi.

Mosqasja e grave në prona të paluajtshme ka pastaj efekt zinxhiror, përkatësisht pasoja drejt fuqizimit dhe mundësive ekonomike.

Mirlinda Kusari - Purrini, drejtoreshë ekzekutive e Shoqatës Afariste të Gruas "SHE-ERA", thotë se shumë gra kanë ide kreative për të filluar një biznes, por nëse nuk kanë prona të regjistruara në emër të vetin, atyre u kufizohet qasja në kredi bankare.

Prona e paluajtshme hyn në kuadër të hipotekës që bankat kërkojnë për ta siguruar përmbushjen e detyrimit ndaj kredive. "Prona është pengesa kryesore që gratë nuk i lejon të zhvillohen", thotë Kusari - Purrini për Radion Evropa e Lirë.

Në një raport të publikuar në nëntor nga Instituti për Studime të Avancuara GAP thuhet se në bankat komerciale të Kosovës vlera e kredive të marra nga burrat arrin në 1.53 miliard euro, ndërsa nga gratë në 642 milionë euro.

Sipas Kombeve të Bashkuara, në gjysmën e vendeve të botës gratë nuk janë ende në gjendje të kërkojnë të drejta të barabarta mbi tokën dhe pronën. Më pak se 15 për qind e të gjithë pronarëve të tokave në botë janë gra.

Si të përmirësohet ky trend?

Në përpjekje për ta ngushtuar këtë hendek, Qeveria e Kosovës në vitin 2016 ka hartuar një udhëzim administrativ, i cili i obligon bashkëshortët që pronën e blerë së bashku, ta regjistrojnë në emër të të dyve, përveç nëse ndonjëri heq dorë në mënyrë vullnetare.

Noterët - te të cilët blerësi dhe shitësi lidhin kontratën dhe pastaj me atë kontratë blerësi e regjistron pronën në zyrën kadastrale komunale - thonë se ka një rritje të regjistrimit të pronave në emër të të dy bashkëshortëve.

Sipas një deklarate të Odës së Noterëve të Kosovës, dhënë Radios Evropa e Lirë, për këtë qëllim ka edhe një stimul, sepse "regjistrimi i pronave në emër të të dy bashkëshortëve bëhet pa pagesë".

Nga koha kur ky udhëzim ka hyrë në fuqi, numri i pronave të regjistruara në emër të grave është rritur për rreth 4 për qind, përkatësisht nga 16 për qind në afro 20 për qind, sipas Agjencisë Kadastrale të Kosovës.

Në mars të vitit të kaluar afati i këtij udhëzimi administrativ është shtyrë deri në vitin 2029. "Synimi ynë nuk ka qenë vetëm çështja e fuqizimit të rolit të gruas në proceset e divorcit, por e dimë se [prona] është parakusht edhe për fuqizimin ekonomik të grave. Thjesht, gratë të mos jenë të penalizuara, nëse dëshirojnë të kenë ndonjë iniciativë të biznesit", thotë për Radion Evropa e Lirë, Edi Gusia, kryeshefe ekzekutive në Agjencinë për Barazi Gjinore, e cila funksionon në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës.

Përfaqësues të sektorit civil pohojnë se Kosova ka ligje të mira në këtë aspekt, por se ato nuk zbatohen në masë. Selimi, nga organizata INJECT, thotë se gjatë takimeve të ndryshme me gra, sidomos në zonat rurale, ka vërejtur se ato nuk janë të informuara mirë për të drejtën e tyre ligjore. "Prandaj, për ta rritur numrin e pronave të regjistruara në emër të çifteve, nevojiten fushata informuese për gratë nëpër vise rurale dhe zbatim i ligjeve nga mekanizmat përgjegjës", thotë Selimi.

Në një raport të Zyrës së Komisionarit të Lartë për të Drejta të Njeriut në Kombet e Bashkuara flitet, po ashtu, për rëndësinë e pjesëmarrjes së organizatave dhe grupeve të grave në të gjithë hapat e zhvillimit të politikave të strehimit, si dhe në përpunimin e ligjeve të reja, në mënyrë që nevojat e grave të merren parasysh.

ATK-ja paraqet arritjet e vitit 2023

Prishtinë, 28 dhjetor - Drejtori ekzekutiv i Administratës Tatimore të Kosovës, Ilir Murtezaj, ka mbajtur konferencën vjetore për medie, me ç'rast fillimisht i ka falënderuar mediet për punën profesionale që kanë kryer duke i informuar drejt dhe saktë të gjitha zhvillimet e institucionit. Ai pastaj ka paraqitur të hyrat e realizuara për këtë vit. Sipas tij, ato janë rritur mbi 120 milionë euro më shumë se një vit më parë. Murtezaj ka thënë se fokus i theksuar këtë vit ka qenë rritja e mekanizmave dhe digjitalizimi i tyre në drejtim të raportimit të rasteve për keqpërdorim të detyrës zyrtare si dhe aferave korruptive.

Ai përmendi që në muajin e kaluar janë lansuar tri shërbime të reja elektronike, siç janë: udhëzuesi interaktiv, aplikacioni i denoncimeve, si dhe kalkulatori tatimor.

Më tutje, para medieve u paraqit efekti i monitorimit strikt të sektorëve me risk tatimor, siç është gastronomia, ku të hyrat e inkasuar janë rritur për 27.2 milionë euro, apo rreth 7 milionë më shumë se viti i kaluar. Trajektorja e suksesit kap edhe pagesat nga këngëtaret, që është 2.7 milionë euro nga 1.7 milion euro sa ishte në vitin 2022.

Ndërsa ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka thënë se është mbresëlënëse performanca e ATK-së, duke pasur parasysh që është viti i tretë që kemi rritje dyshifrore të të hyrave. Ai ka thënë se arritjet e ATK-së janë përtej planifikimeve ekonomike.

"Si ministri jemi duke ofruar mbështetje të madhe me theks edhe në pjesën e Ligjit për Administrimin e Procedurave Tatimore, i cili rregullon shumë segmente të këtij institucioni", ka thënë Murati.

Ai ka thënë se reflektim i kësaj pune janë edhe përmirësimi në pjesën e ndjeshme siç është korrupsioni, evazioni tatimor dhe dukuri të tjera të cilat prekin integritetin e ATK-së.

Në çfarë ore është fundi i botës? Frikërat që nuk na lënë të qetë

A do të shënojë apokalipsi i insekteve fillimin e fundit të biodiversitetit? Apo në vend të kësaj, në një skenar post-atomik, a do të jetë Blattella germanica e vetmja krijesë që do të mbijetojë? Nuk është skenari i "The Last of Us" ose një nga serialeve të shumta televizive në qarkullim (makthet, për skenaristët, janë ëndrrat e reja), por pyetje reale për këto kohë të errëta. Nga ana tjetër, karkalecat që dikur mbushnin Afrikën, sot kanë pushtuar Sardenjen.

Regjistrimi i shtatorit më të nxehtë në histori sigurisht që ka të bëjë me këtë, me gjithë respektin për ata që dyshojnë se klima po çmendet. Ende pa ikur tronditja nga pandemia, e cila ka bërë që konsumimi i anksiolitikëve të rritet, erdhi pushtimi nga Rusia i Ukrainës dhe hipoteza e "luftës së tretë botërore". Më pas, sikur të mos mjaftonte kjo, u hap sërish çështja shekullore izraelito-palestineze, me një prolog tmerri të papërshkrueshëm, më pas masakër dhe ndoshta një përshkallëzim. "A peste, uria et bello, libera nos Domine" thërrasin besimtarët në liturgji.

Tre frikërat e mëdha – epidemitë, uria dhe lufta – nuk kanë ndryshuar. Sa i përket kalorësit të katërt, misterioz të apokalipsit të Dhiatës së Re, sot duket se është Inteligjenca Artificiale. Nga Brukseli në Uashington ka një shtim të ligjeve për të parandaluar daljen jashtë kontrollit, ndërsa vetë krijuesit e ChatGPT kanë krijuar një njësi gatishmërie, përgatitjeje (për më të keqen).

EMERGJENCA E KLIMËS

Dikush mund të pajtohet ose të mos pajtohet me taktikat e Rebelimit të Zhdukjes (Greta Thunberg tha se nuk ishin të sajat, megjithatë, duke qenë se çdo gjë tjetër kishte dështuar, ajo i respekton), por sigurisht kanë patur një intuitë të shkëlqyer: emrin. Nuk luftojnë "ngrohjen e klimës", as "krizën klimatike" më urgjente: rebelohen kundër zhdukjes. Term i ngarkuar, i cili rikthen peshën ekzistenciale të problemit. Deri në atë pikë sa edhe UNDP, programi i zhvillimit të Kombeve të Bashkuara, në vitin 2022 e quajti fushatën e vet për të braktisur hidrokarburet: "Mos zgjidhni zhdukjen". Mbi gjysma e kampionit prej 10,000 të rinjsh të intervistuar nga The Lancet një vit më parë, binin dakord me deklaratën se "njerëzimi është i dënuar". Një shqetësim kaq i madh, saqë u prish gjumin, përqendrimin dhe imagjinatën për të ardhmen. Ekoankthi është një term që ka hyrë në leksikun e zakonshëm.

"Zhdukja e gjashtë" është titulli i librit të Elizabeth Kolbert, fituese e çmimit Pulitzer nga New Yorker për artikuj të mrekullueshëm mbi mjedisin. "Dhjetë vjet pas publikimit", thotë ajo përmes Zoom nga shtëpia e vet në veri të Nju Jorkut – ku ngrica dikur mbërrinte në fillim të tetorit, ndërsa sot, pothuajse një muaj më vonë, as nuk po duket – "ne jemi thjesht dhjetë vjet më keq".

Është ajo që tregon për vdekjen shqetësuese të insekteve evropiane, që janë në bazën e zinxhirit ushqimor të shpendëve, pra të pjalmimit, me pasoja gjigante në bujqësi. Jemi të dënuar apo mund të bëhet diçka? Dhe ç'farë? "Epo, siç thonë, kur je në gropë, ajo është kthyer në kurth: thjesht mos gërmo më! Pra, nuk duhen dhënë më leje për hapjen e impianteve të reja të karburanteve fosile, siç ndodhi në Alaskë ose Rosebank në Britaninë e Madhe: është thjesht çmenduri. Më pas, duhen ndërtuar shumë impiante të rinovueshme, duke e transformuar infrastrukturën e vjetër. Në fund, duhet investuar masivisht në kërkime për të gjetur zgjidhje të reja. Nje shembull? Aviacioni civil: duhet të rimendohet tërësisht".

Sidoqoftë, ne duhet të eksplorojmë të panjohurën duke filluar nga e besueshmja. Këjë e bën shumë mirë anglezja Naomi Alderman tek "The Future". Nxënëse e Margaret Atwood, një tjetër autore që di shumë për distopitë, ajo tregon për një botë të dominuar nga disa perandorë teknologjikë kapriçiozë – tmerrësisht të ngjashëm me Musk-un, Bezos-in, Zuckerberg-un e vërtetë – të cilët, të paralajmëruar nga një sistem ekskluziv mesazhesh, në fillim të romanit nxitojnë në bunkerët e ngritur për raste apokalipsi. Njerëz aq të pasur dhe të fuqishëm saqë mund të vendosin të krijojnë shiun ku të duan, pa e vrarë mendjen për ata që nuk janë të pasur.

Edhe këtu duket si trillim, por krijimi i reve ekziston. Ashtu siç ekziston një kompani hungareze e specializuar në ndërtim vendstrehimesh ultra luksoze. Dhe çfarë mendon Alderman për gradientin apokaliptik të momentit aktual? "Duhet të kemi parasysh tendencën e njerëzve për të mbivendosur ndjenjën e vdekshmërisë së tyre mbi atë të specieve. Ka probleme të mëdha, por nuk mendoj se fundi është i afërt. Megjithatë, më duhet të pranoj se, në fund të tetorit, ka ende luleshtrydhe në kopshtin tim në Londër! Duket e bukur, por është shqetësuese". Një gëzim i palogjikshëm i ngjashëm me atë të daljes në plazh për Vit të Ri.

Mekanizmi mbrojtës që funksionon për të është të dallojë problemet, t'i trajtojë ato një nga një: «Siç thotë çdo psikoterapist i mirë: të ngadalësojmë, të qetësohemi, le të kuptojmë se çfarë po ndodh saktësisht. Kështu zbulojmë se në disa raste, si për shembull Brexit, ishim ne ata që e prishëm shtëpinë". Megjithatë, kalorësit e saj të apokalipsit janë gjigakapitalistët dixhitalë: "Unë i kushtoj shumë faqe për të ilustruar sasinë e gjërave të rëndësishme që mund të bëheshin me një pjesë të parave të tyre", të cilat zhduken në një arrati hapësinore, me Marsin dhe planetët e tjerë që na prezantohen në mënyrë të rreme si alternativa të vlefshme ndaj dështimit në Tokë. Dhe ndërsa «bomba atomike ishte një shpikje e tmerrshme, por të paktën shërbeu për të mposhtur nazistët, inteligjenca artificiale nuk na është «shitur» për të mposhtur Putinin. Kështu që? Nëse ai përfaqëson një rrezik kaq të madh, siç thonë vetë baballarët e saj, e vetmja mundësi është ndalimi i zhvillimit. E kemi parë të gjithë Dr. Strangelove, apo jo?

Fundi i pjesës së parë (bota.al)

Në pjesën e dytë: Rreziku nga Inteligjenca Artificiale

sport



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Sylvinho për mediet braziliane: Duam ta çojmë Shqipërinë edhe në Kupën e Botës

Sao Paolo, 28 dhjetor - Pasi siguroi kualifikimin për në "Euro 2024", Sylvinho tashmë synon ta kualifikojë Kombëtaren e Shqipërisë edhe në Kupën e Botës. Strategu brazilian ka folur për mediet e vendit të tij, duke komentuar edhe shortin për Evropian. "Është e drejtë të thuhet se është grupi më i vështirë. Ata janë të gjithë teorikisht më të fortë se ne. Ne do ta testojmë forcën tonë. Këto janë tri skuadra që me siguri mund të themi se luftojnë për të shkuar sa më larg dhe për ta fituar turneun. Për ne është krenari kur njerëzit thonë 'ka një Shqipëri të vështirë atje'. Ne u kualifikuam në vendin e parë dhe tani ata do të fillojnë të na kushtojnë vëmendje", ka thënë strategu brazilian. "Ajo që ne përpiqemi t'u përcjellim është ideja se ne do të luajmë në një Evropian dhe duhet të përpiqemi të luajmë më shpesh. Pastaj, kush e di në të ardhmen, të arrijë një Kupë Bote. Kjo do të japë mundësi për të luajtur më shpesh, për të qenë më komod në këto kompeticione të rëndësishme. Në Botërorin me Brazilin, duhet të përgatitemi për ta kapërcyer fazën e grupeve, për të fituar 1/16, çerekfinale, gjysmëfinale, për të arritur në finale. Me Shqipërinë çfarë duam? Për të kaluar nga faza e grupeve? Po. A do të mundemi? Unë nuk e di. Përgatitja është të shkojmë sa më larg", ka deklaruar Sylvinho.

Bordi i FBK-së ua ndalon gjyqtarëve nga Kosova të ndajnë drejtësinë në Ligën Ballkanike

"Epoka e re"

Prishtinë, 28 dhjetor - Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) në mbledhjen e fundit për këtë vit ka shqyrtuar situatën aktuale në basketbollin e Kosovës, ndërsa ka miratuar draft plane të shumta, kurse është miratuar edhe kërkesa e KB Pejës të luajë në Ligën Ballkanike. Gjithashtu, FBK-ka ka refuzuar kërkesën e Ligës Ballkanike për delegimin e personave zyrtarë të ndeshjeve nga Kosova.

Bordi i FBK-së ka vendosur si në vijim: E ka miratuar Raportin e Aktiviteteve për vitin 2023, Raportin Financiar për periudhën janar-nëntor 2023, Draft-planin e Veprimit për vitin 2024, Draft-planin e Marketingut 2024, Draft-planin Financiar 2024. Ndërsa ka vendosur të hapë konkurs për organizim të Final 8 Kupës së Kosovës prej datës 28 dhjetor 2023 deri më 8 janar 2024, kurse ka miratuar plotësim-ndryshimet në Rregulloren për Financa të FBK-së. Ky bord ka vendosur ta shtyjë fillimin e stinorit pranveror në Superligën e Femrave.

Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës ka vendosur t'ia vazhdojë mandatin zyrtares për Integritet në Sport në FBK, Vlora Brahës (SPOC Person), derisa Adriatik Rracin, menaxher i Përfaqësueseve të Kosovës, e ka emëruar në pozitën e zëvendësekretarit të Përgjithshëm në FBK. Ndërkohë Driton Obërtincën emërohet në pozitën e Koordinatorit të Përfaqësueseve të Reja të Kosovës. Po ashtu, e ka miratuar pjesërisht kërkesën e KB 3×3 Prishtina si dhe kërkesën e basketbollistit të Kosova 3×3, Bardh Rexha. "Bordi i FBK-së e ka miratuar kërkesën e KB Peja për të luajtur në Ligën Ballkanike. E ka refuzuar kërkesën e Ligës Ballkanike për delegimin e personave zyrtarë të ndeshjeve nga Kosova", thuhet në njoftimin e FBK-së.

Muhamet Hyseni zgjedhet "Sportist i Vitit" në Podujevë

Podujevë, 28 dhjetor - Komuna e Podujevës ka organizuar manifestimin tradicional të fundvitit, zgjedhjen e Sportistit të Vitit, ku u nderuan me mirënjohje sportistë, klube, punëtorë sportivë dhe donatorë. Kryetari Shpejtim Bulliqi në fjalën e tij i përgëzoi sportistët llapjanë për rezultatet e treguara gjatë vitit 2023 si dhe u uroj shëndet të mirë dhe suksese të reja në vitin 2024. "Gjatë këtij viti jemi angazhuar maksimalisht që sporti ta ketë vëmendjen e shtuar nga ana jonë si qeverisje komunale, kemi filluar ndërtimin e Qendrës Multifunksionale, renovimin dhe zgjerimin e palestrës sportive, rritjen e buxhetit për kategorinë e subvencioneve e shumë punë të tjera në dobi të sportit dhe sportistëve në përgjithësi", ka thënë kryetari Bulliqi, i cili është zotuar se mbështetja për klubet me rezultate të larta dhe sportistët e dalluar nuk do të mungojë nga komuna.

Muhamet Hyseni nga Klubi i

Futbollit Llapi u shpall "Sportisti i Vitit" në komunën e Podujevës, kurse vendi i dytë i takoi Demahmet Sinani nga Klubi i Karatesë KK "Boks Kroni", kurse vendi i tretë Ilir Krasniqit nga KF Llapi. Klubi i Vitit u zgjodh KF Llapi, kurse trajneri i vitit Mehmet Agushi. Me epitetin "Shpresë e Sportit" u nderua Mërgim Cërnaverni nga KF Llapi. "Punëtorë Sportivë të Vitit" u zgjodhën Lumbardh Shala nga Klubi i Atletikës Llapi dhe Muhamet Rexhepi nga KF Llapi. "Donatori Sportiv i Vitit" u shpall "Zhitia Turist". "Gjyqtar i Vitit" u zgjodh Fatbardh Rrahimi. "Pedagogu Sportiv i Vitit" u shpall Gramos Latifi. Për prezantimin e aktiviteteve dhe rezultateve të klubeve sportive llapjane me mirënjohje u nderua gazetari i Radio Llapi,t Enver Hyseni. Me mirënjohje u nderuan edhe sportistë të kategorive të reja, punëtorë sportivë, veteranë dhe gjyqtarë. Me mirënjohje postmortem u nderuan Selatin Vokrri, Fehmi Podvorica, Bashkim dhe Vllaznim Restelica.

Skocezët thumbojnë Grezdën: Djali i keq tani i papunë



Të gjithë e mbajmë mend kalimin e Eros Grezdës te Rangers në vitin 2020 për shifrën dy milionë euro, por në klubin skocez gjakovari nuk arriti të lërë shenjë. Mediet skoceze e kanë rikthyer edhe një herë Grezdën në kujtesë, duke e etiketuar si një lojtar që la vetëm shenja për probleme disiplinore. "The Scottish Sun" kthehet të shkruajë për Grezdën, ku nënvizon se më së shumti gjakovari mbahet mend për një gjobë të vendosur nga ish-trajneri Steven Gerrard. "Djali i keq i Rangersit, që u gjobit në trafik dhe për pështymë ndaj kundërshtarit, tani është i papunë", shkruan media skoceze, që duket sikur ka ende "mllef" me gjakovarin. Në kohën kur luante me Rangersin, Grezda mori një gjobë të majme për shkak se pështyu një kundërshtar në një miqësore mes Rangers B dhe Irlandës së Veriut. Gjithashtu, ai pati një ndëshkim shembullor edhe për shkak të mungesës së dokumentacionit të makinës. Një tjetër moment i nxehtë për Grezdën ishte në Kroaci tek Osijeku, ku ai u përlesh me njërin prej kundërshtarëve në tunel. Media skoceze shkruan se Grezda ka ndërruar disa klube dhe se tashmë është i martuar dhe me fëmijë. Pavarësisht prej kësaj, në Shqipëri gjakovari mbahet mend edhe për kohën e tij në Kombëtare dhe periudhën e artë.

‘Bild’ zbulon hollësi të reja nga rehabilitimi i Schumacherit

Munchen, 28 dhjetor - Dhjetë vjet më parë Michael Schumacher pati një aksident të rëndë me ski në Meribel (Francë) dhe nuk dihet pothuajse asgjë për gjendjen e tij shëndetësore. Megjithatë, “Bild” zbuloi hollësi më konkrete në lidhje me rehabilitimin e tij deri më tani. Gjegjësisht, gazeta gjermane shkruan se Schumacheri është vozitur me veturën Mercedes AMG në kuadër të kujdesit dhe rehabilitimit të tij. Qëllimi i kësaj ishte ta stimulonte trurin me tinguj të njohur, pasi Schumacheri kaloi më shumë se dy dekada duke garuar në Formula 1 ose kategori të tjera përpara debutimit të tij në F1 në vitin 1991 në Çmimin e Madh të Belgjikës. Gjithashtu, u zbulua se 15 mjekë, masazhatorë dhe asistentë, janë punësuar për t’u kujdesur për të për t’i ofruar kujdesin më të mirë 24 orë në ditë. Kujtojmë se shtatë herë kampioni i botës pësoi aksident më 29 dhjetor 2013 teksa po bënte ski në alpet franceze, duke goditur kokën në një shkëmb. Edhe pse mbante një helmetë skijimi, ai pësoi lëndime të rënda në kokë dhe u dërgua në një spital në Grenoble ku iu nënshtrua operacioneve dhe u vendos në koma të induktuar.

Superliga trondit UEFA-n, 15 miliardë euro buxhet vetëm për tre sezonet e para

Madrid, 28 dhjetor - Superliga Evropiane nuk ka ndër mend të kursehet për të ngritur në këmbë një turne nga e para. Dhe duke parë shifrat që po investon, është e qartë që po bëhet gati për një turne me përmasa të jashtëzakonshme. Gazetat sportive spanjolle kanë bërë me dije se kompania A22, e cila është ajo që po merret me organizmin e turneut, ka nisur ta përpilojë projektin e ri me tri liga, duke parashikuar edhe buxhetin që i duhet për edicionet e para të turneut. Dhe shifrat për të cilat flitet janë marramendëse. Bëhet me dije se buxheti i caktuar për tri edicionet e para është 15 miliardë euro, që do të thotë se fitimet për pjesëmarrësit do të jenë kolosale në krahasim me çfarë shpërndan aktualisht UEFA. Për më tepër, planifikohet që një fond prej 400 milionë eurosh të kalohet te futbolli amator në Evropë dhe për ato kampionate që nuk përfaqësohen në këtë aktivitet. Fonde marramendëse, të cilat po mblidhen nga investitorë arabë dhe amerikanë dhe që po shqetësojnë UEFA-n, e cila për momentin nuk i garanton më shumë se 200 milionë euro në vit futbollit të atyre që nuk marrin pjesë në aktivitetet e saj dhe ka bërë të lindë frika se mund të humbasë shumë mbështetje. Dhe tashmë që miliardat pritet të vihen në lojë, shumë skuadra, si Interi për shembull në Itali, që ishte pjesë e projektit në fillim, por pas paktit me UEFA-n doli hapur se nuk do të ndërrojë krahë, mund ta rimendojë edhe njëherë vendimin. Gjithsesi, si Interi janë edhe shumë klube të tjera që kanë thënë jo, sidomos ato angleze që i nevojiten pa dyshim këtij turniri për të pasur sukses të plotë, ndërsa në Serinë A ato që do të dëgjojnë drejtuesit e Superliga janë Napoli, Lazio, por edhe Milani dhe Juventusi.

Milwaukee kap kreun në Lindje, fitojnë edhe Philadelphia dhe Phoenixi, zhgënjen Dallasi

REZULTATET

Orlando - Philadelphia	96-112
Washington - Toronto	102-132
Brooklyn - Milwaukee	122-144
Houston - Phoenix	113-129
Oklahoma - New York	129-120
Dallas - Cleveland	110-113

Orlando, 28 dhjetor - Milwaukee ngjitet në krye të renditjes në Konferencën e Lindjes pas fitores me rezultat 144-122 në fushën e Brooklynit. Ndeshje e komanduar nga miqtë, ku u dallua Antetokounmpo me 32 pikë e 10 rebounde, mbështetur edhe nga Middletoni me 27 pikë e 10 rebounde. Fitoi edhe Philadelphia, që mban ritmin e kryesuesve në Lindje, duke mundur me rezultat 112-96 Orlandon. Tre lojtarë realizuan mbi 20 pikë. Shkëlqeu Maxey me 23 pikë. Toronto, falë 26 pikëve të Anuobyt, mundi 132-102 Washingtonin jashtë fushës. Zhgënjeu skuadra e Dallasit, që u mund me rezultat 113-110 nga Clevelandi në sekondat e fundit. LeVert me 29 pikë ishte më i miri për miqtë, ndërsa 39 pikët e Donqiqit mbetën për statistikë. Fitoi edhe Phoenixi, që mundi me rezultat 129-113 Houstonin, sfidë ku dallimin e bëri dyshja Durant-Gordon, që së bashku realizuan 54 pikë.

SHKURT

Rritet ndjeshëm vlera e kartonit të Asanit

Nuk do të duhej të investohej një “thesar” për ta marrë. Jasir Asani mbetet një futbollist me vlerë modeste të kartonit, diçka e kuptueshme për etapat në karrierë, por ngjitja e fortë ka nisur. Sipas vlerësimit më të fundit nga agjencia e specializuar për tregun e futbollit, “Transfermarkt”, sulmuesi i Kombëtares shqiptare ka gati dyfishim të çmimit. Nëse në shkurt të këtij viti kartoni i tij ishte 700 mijë euro, tani flasim për 1.2 milion euro. Natyrisht, shumë më pak se Broja, Kumbulla, Gjimshiti, Bajrami, Asllani apo Uzuni, që luajnë në Itali, Angli e Spanjë, por kjo është normale sepse lojtari nga Shkupi aktivizohet në Korenë e Jugut. Padyshim në këtë rritje kanë ndikuar paraqitjet e tij shumë të mira për kombëtaren shqiptare në eliminatoret e Kampionatit Evropian ku shënoi tri herë dhe ndihmoi ekipin që të kualifikohej për në finalet e vitit të ardhshëm në Gjermani. Edhe në elitën e Koresë së Jugut, Asani po luan mirë dhe ka 7 rrjeta e 3 asistime në 30 ndeshje. Pritet që në janar të transferohet në Evropë, dhe ka zëra se mund të gjejë ekip në La Ligën e Spanjës.

Interi ka në listë tre sulmues, edhe Brojën

Interi po e sheh transferimin e Armando Brojës si opsion në afatin kalimtar të janarit. Përpos Brojës, sipas “Gazzetta dello Sport”, në listën e Interit janë edhe Mehdi Taremi i Portos dhe Anthony Martiali i Manchester Unitedit. Broja po kalon në një formë të dobët me Chelsean pas rikthimit nga lëndimi dhe mundësia e largimit është e madhe.

Calhanoglu refuzon superofertën nga Arabia Saudite

Hakan Calhanoglu po ndihet mirë tek Interi dhe me trajnerin Simone Inzaghin, i cili e shndërroi atë në një nga lojtarët më të fortë në botë pas shitjes së Brozoviqit. I pagabueshëm nga njëmbëdhjetë metra, numri 20 i zikaltërve realizoi shtatë penallti nga po aq goditje nga pika e bardhë nga 8 golat në total të realizuar në këtë sezon mes kampionatit dhe Ligën e Kampionëve. Ish-lojtari i Milanit dhe Bayer Leverkusenit po kalon momentin më të mirë të karrierës së tij dhe po refuzon me forcë sirenat nga Arabia Saudite, gati për ta mbuluar me arë me një kontratë katërvjeçare me vlerë 18 milionë euro në vit. Në thelb trefishi i asaj që merr tek Interi. Megjithatë, nuk ka asgjë për të bërë për sauditët e pasur: në të tashmen dhe të ardhmen e Calhanoglu është vetëm Interi.

Arsenali synon transferimin e De Ligtit

Skuadra e Arsenalit po synon të bëjë një lëvizje befasuese në mbrojtje gjatë afatit kalimtar të janarit. “The Athletic” shkruan të enjten se Arsenali ka shprehur interesim për mbrojtësin e Bayernit, Matthijs De Ligt. Arsenali është i gatshëm të bëjë ofertë për holandezin, i cili nuk po ndihet shumë i lumtur te skuadra gjermane. 24-vjeçari këtë edicion ka vetëm 11 paraqitje për Bayernin në të gjitha garat dhe me skuadrën gjermane ka kontratë deri në verën e vitit 2027. Arsenali po synon huazimin e De Ligtit për gjashtë muaj, me obligimin e blerjes së tij në verë për 60 milionë euro. De Ligt para se t’i bashkohet Bayernit vitin e shkuar, karrierë ka bërë edhe te Juventusi dhe Ajaxi.

Mediet spanjolle: Mbappe nuk do të vazhdojë me PSG-në dhe e do veç Realin

Sulmuesi francez Kylian Mbappe nuk ka vendosur ende nëse do ta vazhdojë karrierën në Paris Saint-Germain apo do të transferohet në Real Madrid. Mediet spanjolle janë të bindura se nënkampioni i botës do t’i japë fund përvojës në “Parkun e Princave”. Sipas emisionit “El Chiringuito”, ish-futbollisti i Monacos nuk dëshiron ta vazhdojë karrierën në kryeqytetin francez. Pasi nga 1 janari do të hyjë në gjashtë muajt e fundit të kontratës, sipas rregullave të FIFA-s, Mbappe do të ketë të drejtë të arrijë marrëveshje me një klub tjetër që nga muaji që po vjen. Mediumi spanjoll është i bindur se që nga janari Mbappe do të nënshkruajë para-kontratë me “Los Blancos”, të cilëve do t’u bashkohet nga vera e ardhshme si lojtar i lirë. Mbappe e kishte vazhduar kontratën me PSG-në në verën e vitit 2022 për dy vjet, duke i befasuar të gjithë pasi ishte shumë pranë transferimit në Madrid. E tash ai nuk e shfrytëzoi mundësinë e vazhdimit të kontratës për një vit tjetër, ashtu siç parashihej, dhe dëshiron të largohet nga Franca për ta realizuar ëndrrën fëmijërore - transferimin në Real Madrid.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Creative Hub" L.L.C. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811373290 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Creative Hub" L.L.C. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811373290 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "Creative Hub" L.L.C. has come to the decision to quit its business: 811373290 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Creative Hub Education" L.L.C. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811912410 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Creative Hub Education" L.L.C. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811912410 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "Creative Hub Education" L.L.C. has come to the decision to quit its business: 811912410 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Asterisk Mobile Store" SH.P.K. me seli në Gjilan, me pronar Burim Selmani, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810080440 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Asterisk Mobile Store" D.O.O. Gnjilane, sa vllasnikom Burim Selmani, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810080440 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "Asterisk Mobile Store" L.L.C. with headquarters Gjilan, with owner Burim Selmani, has come to the decision to quit its business: 810080440 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Arbnore Hili shpall të pavlefshme dëftesat e klasës: 10, 11, 12 të Gjimnazit "Hajdar Dushi".

- Muj Çoçaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - lX SHFMU "Lidhja e Prizrenit" Prizren.

- Kushtrim Baxhaku shpall te pavlefshme 3 dëftesa dhe diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.

- Batjar Binakaj shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHME "Ymer Prizreni" Prizren.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

Në bazë të dispozitave të nenit 21, nenit 25 të ligjit nr. 03/L- 087 për Ndërmarjet Publike, respektivisht neni 13 të ligjit 04/L-111 për ndryshim dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L- 087 për ndërmarjet publike, si dhe ligjit numër 06/L-021 neni 22 për kontrollin e brendshëm të financave publike, Komisioni i Auditimit i Ndërmarjes Publike KRM "Pastrimi" Sh.A. në Prishtinë në mbledhjen e mbajtur me datë 28.12.2023, mori vendim që të rishpallë,konkursin me afate prej 30 dite per Zyrtarin e Auditimit të Brendshem:

K O N K U R S

Pozita e punës: Zyrtar/e Auditimit të Brendshëm - 1 ekzekutues

Vendi dhe lokacioni i Punës: Prishtinë,

Zyrtari i Auditmit të Brendshëm / Nën mbikqyrje të Komitetit të Auditimit

Kohëzgjatja e Kontratës së punës tri (3) vjeçare

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

I raporton komisionit të auditimit dhe bordit të drejtorëve për politikat, programet dhe aktivitetet e zyrës.
Të planifikojë, organizoj dhe mbikqyrë punën e zyrës së Auditimit të Brendshëm, duke përfshirë planifikimin, hartimin dhe menaxhimin e programit për auditim, organizimin dhe delegimin e punëve dhe përllogaritjen e resurseve të nevojshme.
Përgaditja e planit të punës, zbatimi dhe monitorimi.
Të monitorojë zbatimin e të gjitha rekomandimeve të Komisionit të Auditimit.
Të verifikojë përshtatshmërinë dhe fuksionimin e rregullt të kontrolleve të brendshme (duke përfshirë ato financiare), si dhe të raportoj te Komisioni I Auditimit.
Të verifikojë përshtatshmërinë dhe funksionimin e rregullt të sistemeve dhe procedurave të cilat kanë për qëllim të garantojnë zbatimin nga KRM "Pastrimi" Sh.A të të gjitha ligjeve të aplikueshme ne Kosovë.
Të propozoj masa që duhet të ndërrmeren nga kompania për ngritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të veprimtarisë.
Në bazë të planit të auditimit, përgaditë raportet e auditimit për shqyrtim nga Komision i Auditimit.
Bashkëpunon me zyrtarët e ndërrmarjes në koordinim me Kryeshefin Ekzekutiv.
Kryen edhe punë dhe detyra tjera te cilat I caktohen nga komisioni I auditimit.

Kualifikimi, përvoja e punës dhe aftësitë:

- Diplomë universitare në ekonomi, juridik, administratë publike, financa publike, kontabilitet. master në drejtimet ekonomike me theks në kontabilitet dhe auditim do te jetë përparesi
- Së paku 5 vite përvojë pune menaxhuese në auditimi të brendshëm,5 vite pervoje menaxhuese në auditim të brendshëm konsiderohet përparesi;
- Njohuri dhe përvojë në fushën e auditimeve të deshmohet me kontrata, vendime;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme me theks Ligji per NP dhe I ligjeve qe kane te bejne me kontrollin e brendshem dhe menaxhimin e financave publike;

- Shkathtësi ne komunikim, planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi kompjuterike ne aplikacione të programeve (word, Excel, Power Point, Access);
- Të jetë i certifikuar në auditim të brendshëm në sektorin publik leshuar nga MEF ose nga ndonje institucion relevant vendor ose nderkombetar si: përparësi është SKAK, etj.

Paraqitja e kërkesave

1. Kërkesat dorëzohen në zyrën nr. 8. të KRM “Pastrimi”sh.a.rr.Tahir Zajmi’’nr.5, Prishtinë dhe duhet bashkangjitur edhe këto dokumente:
2. CV, Përvoja e punës e deshmuar me dokumente veçmas deshmi për pervojen menaxhuese ne auditim (dokumente origjinale ose te noterizuara) ,Vërtetim nga trusti pensional,Diplomat e shkollimit fakultetit (e noterizuar),Diploma nga universitetet e huaja duhet te jete e nostrifikuar nga Ministria e Arsimit (deshmi e noterizuar), Çertifikata e Auditimit (e noterizuar),Çertifikata e lindjes jo me e vjetër se gjashtë muaj, Kopja e letërnjoftimit, dëshminë se nuk jeni nën hetime jo me e vjeter se gjashtë muaj (origjinali).
3. Deklarata nën betim.
4. Dokumentet e pakompletuara si dhe ato që arrijnë pas afatitit të konkursit, nuk do të shqyrtohen.
5. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.
6. Konkursi është i hapur 30 ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor.
7. Informata shtesë mund të sigurohen përmes telefonit nr.038/603-191.

Kryesuesi i Komitetit Auditimit
Valon Gogiqi

Prema odredbama člana 21. Zakon br. 03/L-087 o javnim preduzećima, odnosno član 13 Zakona 04/L-111 o izmeni i dopuni Zakona br. 13. Br. 03/L- 087 o javnim preduzećima, kao i zakon br. 06/L-021 član 22 o internoj reviziji javnih finansija, revizorski odbor Javnog preduzećaSC "Čišćenje" Š.A. U Prištini, na sastanku održanom 28.12.2023. godine, doneta je odluka o ponovnom preislišanju konkursa sa 30 dana za službenika interne revizije:

K O N K U R S

Radno mesto: Službenik interne revizije - 1 izvršitelj

Lokacija i lokacija: lokacija

Službenik interne revizije / Pod nadzorom Odbora za reviziju

Trajanje ugovora od tri (3) godine

Dužnosti i odgovornosti:

- Izveštaj Odboru za reviziju i Upravnom odboru o politikama, programima i aktivnostima Kancelarije.
- Planiranje, organizovanje i nadgledanje rada Kancelarije za unutrašnju reviziju, uključujući planiranje, projektovanje i upravljanje programom revizije, organizovanje i organizovanje i Delegacija radova i obračun potrebnih resursa.
- Pripremite plan rada, implementaciju i praćenje.
- Pratite primenu svih preporuka Odbora za reviziju.
- Proverite adekvatnost i redovno funkcionisanje internih kontrola (uključujući i finansijske) i javite se Odboru za reviziju.
- Provera prikladnosti i redovnog funkcionisanja sistema i procedura koje imaju za cilj garantovanje implementacije od strane RM "Čišćenje" Sh.A. svih zakona Primenljivo u Nigeriji.
- Predložite mere koje preduzeće mora preduzeti da bi se povećala efikasnost i efikasnost delatnosti.
- Na osnovu plana revizije, pripremite revizorske izveštaje za razmatranje od strane Odbora za reviziju.
- Sarađuje sa zvaničnicima undertaxa u koordinaciji sa glavnim izvršnim direktorom.
- On takođe obavlja druge poslove i zadatke koje mu je dodelio revizorski komitet.

Kvalifikacije, radno iskustvo i veštine:

- Univerzitetska diploma iz ekonomije, prava, javne administracije, javnih finansija, računovodstva.
  Master u ekonomskim pravcima sa akcentom na računovodstvo i reviziju biće napredovanje
- Najmanje 5 godina iskustva u upravljanju internom revizijom, 5 godina iskustva u upravljanju internom revizijom smatra se prvom linijom fronta;
- Znanje i iskustvo iz oblasti revizije koje treba pokazati ugovorima, odlukama;
- Poznavanje važećih zakona i propisa u skladu sa Zakonom o UN i zakonima koji se odnose na unutrašnju kontrolu i upravljanje javnim finansijama;

- Komunikacione veštine, planiranje rada i vođstvo tima;
- Računarske veštine u softverskim aplikacijama (word, Excel, Power Point, Access);
- Budite sertifikovani u internoj reviziji u javnom sektoru koju razmatra MEF ili bilo koja relevantna lokalna ili međunarodna institucija kao što je: prioritet je SKAK, itd.

Prosleđivanje zahteva

1. Zahtevi se podnose kancelariji br. 8. KRM "Cleaning", Sh.a.s. Tahir Zajmi's no.5, Pristina and these documents must be attached:
2. CV, Radno iskustvo demonstrirano sa posebnim dokumentima dokaz za iskustvo menadžmenta u reviziji (originalna ili notarizovana dokumenta), Uverenje iz penzijskog fonda, Diploma o školovanju (notarizovano), Diploma sa stranih univerziteta mora biti obaveštena od strane Ministarstva prosvete (notarizovani sertifikat), Izvod iz revizije (notarizovan), Izvod iz matične knjige rođenih ne stariji od šest meseci, Kopija ID-a, dokaz da niste pod istragom ne stariji od šest meseci (original).
3. Izjave pod zakletvom.
4. Nepovezana dokumenta i oni koji stignu posle isteka roka za takmičenje neće biti razmatrani.
5. Biće kontaktirani samo kandidati koji su ušli u uži izbor.
6. Konkurs je otvoren 30 dana od dana objavljivanja u dnevnoj štampi.
7. Dodatne informacije možete dati telefonom 038/603-191.

Predsednik Odbora za reviziju
Valon Gogići

100%
Fresh &
Natural
VIDAS
Llatte
drink
2%
TAMËL
PRODHUAR ME
FINESË DHE DASHURI
2,8%
Schmand
ajkë e freskët
sour cream
18% yndyrë
800g
JOGURT
DHALLË
NGA QUMËSHTI I FERMAVE TONA

MEKA
HALAL FOOD
PASHTETË PULË
gluten free
100% mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues